

VENDIM
Nr. 573, datë 3.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të disa objekteve të ndodhura në pronën me emërtim “Qendra e Formimit Policor, Sauk – Tiranë”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas formularëve bashkëlidhur.

Lista me 7 (shtatë) objekte, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 1 (një) fletë.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Institucioni I Pushtetit Qendror MB (Qendra e Formimit Policor)											
Bashkia / Komuna Sauk											
Fusha e perdorimit te Prones: Ne Sherbim te Policise											
Nr. Rend	A		B				C				Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/ vend ndodhja komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
			Qendra Formimit Policor							Ne VKM nr.250,dt.24.04.2003, ndryshuar me VKM nr.317, date 21.04.2011, ne formularin "3" te inventarizimit te pasurise perfshihet Prona Qendra Formimit Policor, me nr.rendor 1-19	
1				Godina nr.3	Magazina Nr.1	147	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor	Pronat me nr. rendor nga 4,6,7,12,18,19, jane miratuar per prishje nga Komisioni MPB sipas VK nr.332/7,dt.14.10.2011	
2				Godina nr.5	Magazina Veshmbathjes	545.5	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor	me siperfaqe ndertimi 3361.5m²	
3				Godina nr.6	Ish-Polygon Qitje	518	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor	Prona me nr.15, eshte miratuar per prishje nga Titullari Ministrise Puneve te Brendshme sipas shkreses nr.8355/1, dt.25.01.2014	
4				Godina nr.11	Dhome Zhveshje	65	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor	me siperfaqe ndertimi 600m²	
5				Godina nr.14	Instituti Policise	600	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor	Pronat/objektet qe kerkohen te hiqen nga lista e inventarit te MB perbehet me komponentet perberes kollona "5" ne kete formular	
6				Godina nr.19	Palester	1040	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor	me Sip.Nd. 3960.5m² sipas kollones "7" e cila do te rezultojte siperfaqe trualli I lire	
7				Godina nr.20	Magazine	1046	heqje nga inventari	Ministria Puneve te Brendshme	Qendra Formimit Policor		